

AKT THEMELIMI I QENDRËS SË FORMIMIT PROFESIONAL, I EDUKIMIT TË VAZHDESHËM E GJATË GJITHË JETËS DHE I ARSIMIT PËR TË RRRITUR ME EMËRTIM "KOLEGJI PROFESIONAL NDËRKOMBËTAR"

Anëtarët themelues të poshtë shënuar themeluan sot më 18.08.2014, në Tiranë, në bazë të ligjit nr.9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, Qendrën e Formimit Profesional, të Edukimit të Vazhdueshëm e Gjatë Gjithë Jetës dhe të Arsimit për të Rritur me emërtim "KOLEGJI PROFESIONAL NDËRKOMBËTAR", veprimtaria e të cilit do të rregullohet nga dispozitat e këtij akti, nga statuti, rregullorja dhe ligjet në fuqi.

KAPITULLI I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 "KOLEGJI PROFESIONAL NDËRKOMBËTAR", quajtur në vazhdim "KPN", themelohet në formën e sh.p.k. nga themeluesit e tij, quajtur në vazhdim "Themeluesit", me synim arritjen e qëllimeve të tij dhe kryerjen e veprimtarisë në territorin e Republikës së Shqipërisë e jashtë saj.

1.2 **Selia provizore:** Rruga" S.Pasha", Pallati 124, Shkalla 3/32, Tiranë, Shqipëri. Selia definitive do të përcaktohet më vonë.

1.3 **Emërtimi i plotë:** "KOLEGJI PROFESIONAL NDËRKOMBËTAR" sh.p.k.

1.4 **Afati:** Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar është themeluar për një periudhë të pacaktuar.

1.5 **Statusi ligjor:** "KPN" është një person juridik, i cili ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ai mund të krijojë filiale, degë dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi si dhe mund të krijojë qendra të specializuara këshillimi, të kryejë veprimtari botuese dhe veprimtari të tjera sipas statutit, udhëzimeve dhe në interes të ortakëve të tij.

1.6 **Stema:** "KPN" ka një letër me kokë dhe një stemë, e cila është përcaktuar në përputhje me ligjin, një vulë dhe materiale të tjera të nevojshme për veprimtarinë e tij. Stema dhe vula janë si më poshtë:

1.7 Çdo ndryshim ose modifikim i këtij akti themelimi ka fuqi ligjore ndaj palëve të treta nga momenti i regjistrimit të ndryshimeve në Regjistrin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

1.8 "KPN" do të përdorë të gjitha të ardhurat e përfituara nga veprimtaria e tij për qëllimet e përcaktuara në këtë akt themelimi dhe në statutin e tij.

1.9 "KPN" nuk do të mbështesë asnjë parti politike, grupim zgjedhor apo kandidat në lidhje me çfarëdo funksioni pranë autoriteteve publike dhe nuk do të përdorë asnjë pjesë të të ardhurave ose të pronës së tij për financimin e tyre.


1.10 "KPN" ka një pasuri të veçantë, të nevojshme për veprimtarinë e përcaktuar në këtë akt themelimi dhe në statutin e tij dhe merr përsipër çdo detyrim që lidhet me këtë pasuri.

1.11 **Vendndodhja e veprimtarive:** "KPN" zhvillon aktivitetin e tij në Tiranë dhe në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ku do të ketë filialet e tij.

KAPITULLI II - QËLLIMET E "KPN" DHE MËNYRAT E REALIZIMIT

2.1 Qëllimi i "KPN" është:



1


- të promovojë dhe zhvillojë formimin profesional postsekondar, edukimin e vazhdueshëm dhe gjatë gjithë jetës dhe arsimin për të rritur, në programet dhe kurset e përcaktuar prej tij,
- të lehtësojë punësimin dhe mobilitetin e të rinjve e të rriturve, duke ruajtur njëkohësisht profilin e një entiteti juridik cilësor,
- të promovojë dhe inkurajojë kontribute në zhvillimin e komunitetit dhe në aksione sociale.

Ky qëllim do të arrihet me ndihmën e mjeteve të mëposhtme:

- Pjesëmarrja në fillimin, zhvillimin dhe promovimin e programeve e kurseve të formimit profesional postsekondar, të edukimit të vazhdueshëm dhe gjatë gjithë jetës si dhe të arsimit për të rritur në bashkëpunim me botën e biznesit;
- Pjesëmarrja, në bashkëpunim me aktorët kryesorë të sferës së punësimit, në dialogun social, në përgatitjen e projektligjeve dhe akteve të tjera ligjore, në dhënien e kontributit për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të këtij sektori si edhe të strategjive të lidhura me punësimin dhe mbrojtjen e punësimit, me formimin profesional postsekondar, të edukimit të vazhdueshëm dhe gjatë gjithë jetës si dhe të arsimit për të rritur duke e orientuar këtë proces në përputhje me trendet e zhvillimit të ekonomisë së tregut;
- Mbrojtja ligjore e të drejtave dhe interesave të tij;
- Komunikimi mbi veprimtarinë e "KPN";
- Botimi, riprodhimi dhe publikimi i materialeve metodikë, profesionalë e shkencorë për promovimin e rezultateve të zhvillimit shkencor dhe të arritjeve të vetë KPN;
- Zhvillimi, zbatimi dhe realizimi i projekteve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, për të zhvilluar potencialin profesional, teknik e shkencor dhe për arritjen e objektivave të KPN;
- Lidhja e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale me personat juridikë dhe fizike, për të realizuar qëllimet e përcaktuara në statut;
- Blerja e pasurive të luajshme dhe të paluajshme, të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë dhe funksionimin e duhur të KPN;
- Organizimi dhe / ose pjesëmarrja në takime, konferenca, simpoziume, kongrese, forume, tryeza të rumbullakta, ekspozita, seanca komunikimi të specializuara me pjesëmarrje të një publiku vendas dhe të huaj, bashkëpunim aktiv me organizata të huaja të ngjashme;
- Kontributi për mbështetjen këshillëdhënëse dhe ndihmë në fushat prioritare të trajnimit për formimin profesional postsekondar;
- Kryerja e detyrave të tjera që nuk bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për të realizuar qëllimet e përcaktuara në statut;

2.2 Në përputhje me Ligjin nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare me përgjegjësi të kufizuar", "KPN" ka të drejtë të kryejë veprimtari ekonomike që rrjedhin nga qëllimet e tij të përcaktuara në statut dhe ekskluzivisht për arritjen e tyre.

2.3 "KPN", gjithashtu, ka si qëllim të tij analizimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave kulturore, profesionale dhe morale të stafit të tij dhe të të gjithë atyre që marrin pjesë në promovimin e trajnimit




në këtë qendër profesionale jopublike.

2.4 "KPN" angazhohet të sigurojë respektimin e ligjit, të etikës profesionale gjatë veprimtarisë trajnuese dhe kërkesat e konkurrencës së ndershme në funksion të zhvillimit të programeve apo kurseve të rinj.


2.5 "KPN" mund të ofrojë shërbime konsulence, ekspertize dhe asistencë ligjore për stafin e tij.

KAPITULLI III - VEPRIMTARIA E "KPN"

3.1 **Kuadri Rregullator:** "KPN" i nënshtrohet dispozitave të këtij akti themelimi, statutit dhe legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë gjatë gjithë veprimtarisë së tij.

3.2 **Të drejtat:** Në mënyrë që të zhvillojë veprimtarinë e vet "KPN" do të ketë të drejtat e mëposhtme:

- Të përfaqësojë dhe të mbrojë interesat e Themeluesve dhe ortakëve në rang kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Të zhvillojë në Shqipëri të gjitha veprimtaritë e parashikuara në këtë akt themelimi, në statut dhe veprimtari të tjera të autorizuara nga legjislacioni shqiptar;
- Të përfaqësojë interesat e ortakëve para autoriteteve publike dhe organizatave të tjera, si dhe para çdo personi juridik apo fizik dhe të ndërmarrë çdo veprim ligjor dhe veprime të tjera të nevojshme për të arritur qëllimet e tij;
- Të bashkëpunojë me organizmat shtetërore në Shqipëri dhe të marrë të gjithë informacionet, dokumentet dhe aktet e tjera zyrtare të dobishme për aktivitetin e tij;
- Të lidhë, me persona juridikë dhe fizikë, marrëveshje bilaterale dhe multilaterale të bashkëpunimit arsimor, teknik, shkencor, ekonomik, financiar dhe tregtar për kryerjen e punimeve dhe ofrimin e shërbimeve për të arritur qëllimet dhe detyrat e përcaktuara në aktin e themelimit dhe statut;
- Të hapë dhe të mbyllë llogari bankare, të nevojshme për veprimtarinë e tij, pranë bankave të licencuara në Shqipëri dhe jashtë vendit, dhe të kryejë transaksione bankare në përputhje me kushtet kontraktuale që ai i konsideron të përshtatshme;
- Të disponojë aktivet e tij dhe t'i administrojë ato në atë mënyrë që të mundësohet zhvillimi i veprimtarisë së KPN dhe të përfitohen të gjitha burimet financiare dhe materiale, të tundshme dhe të patundshme;
- Të pranojë donacione, subvencione dhe sende dhe t'i disponojë ato;
- Të punësojë stafin e nevojshëm për veprimtarinë e KPN ku mund të marrin pjesë qytetarë të Republikës së Shqipërisë dhe / ose vendeve të tjera - dhe të përcaktojë nivelin dhe kushtet e pagesës dhe kushtet kontraktuale, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë;
- Të ushtrojë plotësisht atributet të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin e punës të Republikës së Shqipërisë, Kodin e Punës, Kodin Civil, Kodin e Procedurës Civile, etj;
- Të shpërndajë lirisht informacion në lidhje me aktivitetin e tij, të krijojë në përputhje me ligjin filiale ose të marrë pjesë si themelues në themelimin e organizimeve të tjera me kapital të përbashkët, në funksion të realizimit të qëllimeve statutore;
- Të lidhet me qendra analoge, kolegje profesionale, universitete, qendra kërkimore –shkencore



3



dhe organizata ndërkombëtare e të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi në fusha të ndryshme me to;

- Të drejta të tjera të lejuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.

3.3 Detyrimet: Në mënyrë që të zhvillojë veprimtarinë e tij në përputhje me parashikimet e këtij akti themelimi, të statutit dhe të rregullores, "KPN" ka detyrime si në vijim:

- Të sigurojë zbatimin e vendimeve, dispozitave dhe udhëzimeve të Bordit Drejtues dhe të Administratorit të Përgjithshëm;
- Të veprojë në mirëbesim dhe në interes të ortakëve; t'i informojë plotësisht ata mbi veprimtarinë trajnuese profesionale e mbi rezultatet financiare dhe të sigurojë pjesëmarrjen e tyre në çdo vendim që ka efekte financiare.
- Të paguajë taksat dhe tatimet e në përputhje me legjislacionin fiskal;
- Të respektojë Kushtetutën dhe legjislacionin shqiptar, normat e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me veprimtarinë e sh.p.k.-ve, si dhe rregullat e vendosura nga statuti i KPN.

KAPITULLI IV - PASURIA E "KPN"

4.1. Me qëllim zhvillimin e veprimtarisë, Themeluesit dhe ortakët e "KPN" venë në dispozicion:

- kapitalin themeltar në vlerë 100 000 lekë sipas këtij përcaktimi: Administratori i Përgjithshëm dhe aksioneri kryesor – 80% të aksioneve, ose 80% të kësaj shume e barabartë me 80 000 lekë;
- 2 ortakët dhe aksionistët e tjerë, nga 10% të aksioneve secili ose nga 10 000 lekë secili.

E gjithë pasuria e "KPN", e cila përfshin asetet, sendet materiale dhe burimet financiare të regjistruara në bilancin e tij përbën pronën e KPN. **Anëtarët e tjerë të stafit nuk kanë të drejta pronësie mbi pasurinë e KPN.**


4.2 Burime të tjera të pasurisë

Burime shtesë të pasurisë së "KPN" janë:

- Kuotat e pagesës së studentëve;
- Publikimet e teksteve mësimore dhe literaturës shkencore të domosdoshme për zhvillimin e trajnimeve;
- Botime të ndryshme;
- Konsulenca shkencore dhe ofrimi i ekspertizës për të tretët;
- Donacione dhe subvencionime të ndryshme të veprimtarisë;
- Arkëtime të ndryshme që rezultojnë nga organizimi i konferencave, seminareve, simpoziumeve, workshopeve, manifestimeve, ekspozitave dhe veprimtarive të tjera publike të organizuara në kuadrin e qëllimeve të parashikuara në këtë akt themelimi dhe në statut;
- Të ardhurat e marra nga veprimtaritë e zhvilluara nga KPN ose me pjesëmarrjen e këtij të fundit;
- Shpenzimet e pjesëmarrjes në kurset e trajnimit dhe zhvillimit profesional;
- Burime të tjera të lejuara me ligj.

4.3 Kufizimet mbi përdorimin e të ardhurave:

- Administratori i Përgjithshëm dhe ortakët e tjerë do të paguhen me rrogë vjetore, vlera e së cilës do të përcaktohet nga të ardhurat, por, ajo nuk mund të kalojë mbi 30% të fitimeve;



- Të ardhurat e tjera të mbledhura nga "KPN" si vijim i veprimtarisë së tij, dhe fitimet vjetore do të përdoren ekskluzivisht për arritjen e qëllimeve dhe të detyrave të parashikuara në statut si dhe për qëllime zhvillimi të KPN.

KAPITULLI V - PËRFAQËSUESI LIGJOR

Z. Ladi Jorgo Shahini, në cilësinë e Administratorit të Përgjithshëm të "KOLEGJIT PROFESIONAL NDËRKOMBËTAR" është përfaqësuesi ligjor i tij.

KAPITULLI VI – Ortakët e parë – THEMELUESIT


Ortakët themelues të "KPN" janë personat e mëposhtëm:

Ladi Jorgo Shahini - Administrator i Përgjithshëm
Johana Ladi Shahini – Zv/Administratore e Përgjithshme;
Gent Ladi Shahini – Zv/Administrator i Përgjithshëm;

Duke konsideruar nenet e sipërpërmendur, ky akt themelimi i "KPN" miratohet nga ortakët themelues dhe nënshkruhet më 18 Gusht, 2014.

NËNSHKRIMET E THEMELUESVE/ ORTAKËVE TË PARË

Ladi Jorgo Shahini



Gent Ladi Shahini



Johana Ladi Shahini

